



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER SHPRESA GJOCI
ADRESA NJESIA AMDINISTRATIVE
NR. 5,
TEL: 0682071706

VËRTETIM NËNSHKRIMI NË AKTE TË NDRYSHME OSE NË DEKLARATA PERSONALE

Nr. repertori: 4800

Tirane më 01/06/2021



Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



V2021053920164094586

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER SHPRESA GJOCI**



V2021053920164094586

**DATE 01/06/2021
NR REP 4800**

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 01.06.2021(DY MIJE E NJEZETE E NJE), para meje Notere SHPRESA GJOCI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NJESIA AMDINISTRATIVE NR. 5, , u paraqit personalisht:

DEKLARUES/IT:

Skënder Gjoni, atësia Sejdi, amësia Hyse, shtetas Shqiptar, lindur në Tpla, Tropojë dhe banues në Tiranë, me adresë Bulevardi.Z.Pare.; Nd. 5; H. 2; Ap. 7; Njësia Administrative Nr. 9; Tiranë; 0000; Tiranë, lindur më 05/02/1958, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034000738 dhe nr. personal F80205129V , .

Subjekti i mësipërm, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqit dhe nënshkroi përpara meje Noteres.

Unë Noteri/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

SHPRESA GJOCI



STATUI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR **“PLATINUM CONSTRUCTION” SHPK**

KREU I

EMRI I SHOQËRISË, SELIA, KOHËZGJATJA, OBJEKTI

NENI 1

EMRI I SHOQËRISË

1.1 Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “Platinum Construction” SHPK (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).Data e themelimit është data 01.06.2021 sipas Akt Themelimit.

NENI 2

SELIA

2.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën : Rruga Bulevardi Zogu I Pare, Ndërtesa 5, Hyrja 5, Apartamenti 7, Kodi Postar 1016, Tiranë, Shqipëri.

2.2 Me vendim të administratorit selia e shoqërisë mund të ndryshohet, mund të hapen degë dhe zyra përfaqësimi të saj brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

NENI 3

KOHËZGJATJA

3.1 Shoqëria do te zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar.

NENI 4

OBJEKTI

4.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke u fokusuar kryesisht në:
Projektim dhe ndertimi i objekteve civile apo industriale dhe menaxhimi i zbatimit te projekteve te kesaj natyre per vete dhe per te trete; Shitja e objekteve / njesive te ndertuara si investitor dhe/ose



dhenia e tyre me qira; Shfrytezimin e zonave malore apo bregdetare/plazheve per qellime turistike, duke administruar, dhene me qira, ndertuar objekte rekreative dhe duke ofruar sherbime ne fushen e turizmit, argetimit, bar, restorante ne zona turistike etj.; Importi-eksporti shitja me shumice e pakice e lendeve te para te ndertimit, pajisjeve elektrike, elektronike, hidrosanitareve, mobileri, pajisje zyrash, kancelari,automjete,mjete motorrike, pjese kembimi auto e makineri te çdo lloji, pajisje teknologjike etj. Transporti i mallrave dhe udhetareve brenda dhe jashte vendit; Ofrimi i sherbimit te konsulences ne fushen e biznesit, menaxhimit, taksave etj. Kryerjen e aktivitetit te menaxhimit te riskut dhe sherbimeve keshillimore te sigurise dhe shendetit ne pune. Sherbime parkingu, sherbime lavazhi,sherbime turistike.Dhenien e automjeteve me qera, shitje automjetesh te perdorura.Shitje makinash.Vleresim te pasurive te paluajtshme. Gjithashtu, Shoqeria mund te kryeje cdo lloj veprimtarie apo trasaksion tjetër që lidhet me pasuri të luajtshme e te paluajtshme, me kryerjen e veprimeve tregtare, industriale, bankare dhe/ose financiare te cfaredo lloji dhe natyre, te nevojshme ose te dobishme per arritjen dhe ose plotesimin e objektivit te Shoqerise, qe nuk ndryshon aktivitetin paresor te Shoqerise dhe nuk bie ne kundershtrim me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Import eksport dhe tregtim me shumicë e pakicë të mallrave të ndryshëm ushqimorë,bimë medicinale, industriale, elektroshtëpiake, karburantë.Fabrike uji dhe perpunim lengjesh.Kryerja e investimeve të ndryshëm në sektorët e ndërtimit, rrugë, ura, nënkalime, mbikalime, vepra arti të mëdha dhe të vogla, autostrada, trase, porte, aeroporte, hekurudha, diga, tunele etj. Linja ujësjellësi, gajesjellësi, depo uji, vepra vaditëse etj. Vepra mbrojtëse lumore, hidroteknike, bonifikime etj, punime në gurorë, material inerte etj, Punime impjanti të energjisë elektrike, centrale, hidrocentrale, stacione e nënstacione elektrike, kabina e trasformatorë, linja elektrike të tensioneve të ndryshme si dhe të shpërndarjes. Punime ndërtime detare dhe nën ujë. Punime të ndryshme të inxhinierisë të mjedisit. Punime për ndërtime civile, industriale, turistikike, përfshirë punime për plotësim me rifiniturat, suva, gipse, drurë, duralumin, plastikë, xhami, etj. Rikonstruksione objektësh ndërtimore etj, impjante të brendshme elektrike, hidraulike, telefonie telekomunikacione, interneti, tv, kondicionim, aspirim, etj. Ndërtime parafabrikat, konstruksione metalike, druri, etj. Punime impjante hidrosanitare, ngritëse e transportuese etj. Punime të mbrojtjes dhe sinjalistikës rrugore, Punime strukturore shtresa e mbistruktura speciale, punime gjeodezike, punime gjeologo -inxhinierike etj, por pa u kufizuar në këto projekte dhe investime të ndryshme në to. Transporti rrugor, hekurudhor, ujqor dhe ajror. Projektim, ndërtim dhe mirëmbajtje në fushën e Hoteleri Turizmit, të infrastrukturës, qendrave të biznesit etj. Ndërtim dhe shfrytëzim i pikave të shpërndarjes së karburanteve dhe serviseve e parkingjeve për automjete.

4.2 Për përmbushje të objektit të saj shoqëria :

- a) Mund të marrd pjesë dhe të jetë e interesuar në shoqëri dhe sipërmarrje, shqiptare apo të huaja, që kryejnë aktivitete të njëjta, të ngjashme apo të lidhura me aktivitetin e saj ose te subjekteve pjesëmarrëse;
- b) Mund te lidhë kontrata shitblerje, pdrdorimi, shkëmbimi, sipërmarrje apo marrëveshje të tjera me investitorë, bashkë investitorë, pronarë trualli apo objektesh, operatorë dhe administrues të strukturave turistike;
- c) Mund të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme ose të dobishme ose që kanë të bëjnë, përfshirë por pa u kufizuar në: ofrimin e garancive reale dhe/ose personale pdr detyrimet e veta dhe së të tretëve, veprime me pasuri të luajtshme, te paluajtshme, tregtare dhe çdo veprim tjetër që ka të bëjë me objektin e saj ose që mundëson një përdorim me të mirë të strukturave dhe/ose burimeve

ndërmjet shoqërive ose sipërmarrjeve në të cilat, direkt apo indirekt, shoqëria ka pjesëmarrje apo kontrollin e tyre.

4.3 Shoqëria mund të veprojë në Shqipëri dhe jashtë saj dhe të kryejë çdo aktivitet tjetër të lidhur, ndihmës me qëllim të përmbushjeve ose të jetë i dobishëm për përmbushjen e objektit të saj.

KREU II

KAPITALI, KALIMI KUOTAVE, ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT, VULA

NENI 5

KAPITALI I SHOQËRISË

5.1 Kapitali i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë. Kapitali i shoqërisë nënshkruhet menjëherë dhe do të paguhet nga ortaku i vetëm që zotëron 100% (njëqind përqind) të kontributeve në kapitalin e shoqërisë, përkatësisht :

Z. Skënder Gjoni, shtetas shqiptar, i lindur në Tpl, më 05.02.1958, identifikuar me pasaportën me nr. BF4358275 dhe nr. Personal: F80205129V, i cili zotëron 100% (njëqind përqind) të kapitalit.

5.2 Ky kapital është i ndarë në 1 (një) kuotë të zotëruar 100% (njëqind përqind) nga ortaku i vetëm si më sipër.

NENI 6

KALIMI I KUOTAVE

6.1 Kuotat e kapitalit të shoqërisë mund të fitohen nëpërmjet kontributit në kapitalin e shoqërisë, shitblerjes, trashëgimisë, dhurimit apo çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

6.2 Me vullnetin e administratorit kapitali themeltar mund të transferohet edhe personave të tretë.

NENI 7

ZMADHIMI I KAPITALIT

7.1 Ortaku i cili është themelues i kësaj shoqërie me vullnetin e tij mund të shtojë kapitalin themeltar të shoqërisë në çdo periudhë që ai e sheh të nevojshme.



NENI 8

ZVOGËLIMI I KAPITALIT

8.1 Në çdo rast, kapitali i shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën kufirin e përcaktuar me ligj.

8.2 Ortakët e përballojnë zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë, në përpjestim të drejtë me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e shoqërisë.

NENI 9

VULA

9.1 Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme me logon dhe tekstin brenda saj.

KREU III

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

NENI 10

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

10.1 Asambleja e Përgjithshme është organi vendimarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vendos mbi të gjitha çështjet për të cilat është kompetente sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë, sipas këtij Akt Themelimi dhe Statuti dhe/ose çdo marrëveshje midis ortakëve të Shoqërisë.

10.2 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, të shpreh vullnetin e tij si dhe të votojë në përputhje me pjesët e kapitalit që ai zotëron në Shoqëri.

10.3 Çdo ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga një përfaqësues i deleguar me prokurë me shkrim.

10.4 Ortaku nuk mund të delegojë të drejtën e votës për një pjesë të kuotave të tij të kapitalit, nëse ai voton personalisht për pjesën e mbetur.

10.5 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (conference call) audio ose video, në përputhje me legjislacionin për shoqëritë tregtare dhe komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të quhet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari i saj dhe Sekretari i mbledhjes, me qëllim që të hartohet dhe të nënshkruhet procesverbali përkatës.

10.6 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga Administratori/ët ose nga ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit të Shoqërisë. Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim ose me mjete elektronike, dërguar secilit prej ortakëve në adresat e njoftuara Shoqërisë, të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes.

10.7 Asambleja e Përgjithshme do të mbledhet rregullisht, pavarësisht nga këto formalitete, në rast se të gjithë ortakët apo përfaqësuesit e tyre janë të pranishëm dhe bien dakort për rendin e ditës.

10.8 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kryesohen nga Administratori/ët. Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për çdo mbledhje midis personave të pranishëm.

10.9 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të lenë me shkrim dhe të firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kërkesë të ortakëve, vendimet duhet të perfshijnë dhe deklaratat apo vërejtjet e tyre.

10.10 Asambleja e Përgjithshme mbledhet të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllia e vitit financiar.

10.11 Asambleja e Përgjithshme, në rastin e vendimeve që kërkojnë shumicën e zakonshme, merr vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote ose përfaqësuesit e tyre, që zotërojnë më shumë se 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë, përveç rasteve të parashikuara më poshtë në nenin 10.12. Në rast se ky kuorum nuk arrihet, Asambleja e Përgjithshme thirret në një mbledhje të dytë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga mbledhja e parë.

10.12 Asambleja e Përgjithshme vendos me votat pro të 3/4 të ortakëve pjesëmarrës apo të përfaqësuar që zotërojnë më shumë se 50% të kapitalit të Shoqërisë për ndryshimin e këtij Akt Themelimi dhe Statuti, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

KREU IV

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 11

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

11.1 Shoqëria administrohet nga një apo më shumë Administratorë të cilët zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë kohore të pacaktuar. Administratori mund të rizgjidhet dhe shkarkohet në çdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme.

11.2 Administratori zotëron kompetenca të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha aktet që konsideron të nevojshme për realizimin e objektivit të Shoqërisë,



përveç atyre që ligji apo ky Akt Themelimi dhe Statut ia rezervon Asamblesë së Përgjithshme apo organeve të tiera të Shoqërisë.

11.3 Administratori vepron në përputhje me politikat tregtare ta vendosura nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera në administrimin e Shoqërisë. Administratori mund të delegojë persona të tretë për kryerjen e veprimeve dhe akteve që kanë të bëjnë me administrimin e Shoqërisë, duke mbajtur përgjegjësi për të gjitha veprimet e kryera nga të tretët e deleguar për administrimin e Shoqërisë.

11.4 Administratori do të veprojë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të Shoqërisë. Në rast konflikti interesi, Administratori do të njoftojë menjëherë ortakët si dhe do të heqë dorë nga çdo veprim që lidhet me objektin e konfliktit të interesit deri në marrjen e udhëzimeve nga Asambleja e Përgjithshme.

11.5 Administratori i parë i Shoqërisë do të jetë: Z. Skënder Gjoni, shtetas shqiptar, i lindur në Tpla, më 05.02.1958, identifikuar me pasaportën me nr. BF4358275 dhe nr. Personal: F80205129V, i cili zotëron 100% (njëqind përqind) të kapitalit.

NENI 12

PERFUNDIMI I DETYRËS SË ADMINISTRATORIT

12.1 Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

- i përfundon mandati;
- shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme;
- jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar Shoqërinë;
- personi nuk gëzon cilësinë e Administratorit sipas parashikimeve të ligjit;

KREU V

KONTROLLI FINANCIAR, VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR

NENI 13

KONTROLLI FINANCIAR

13.1 Kontrolli financiar i shoqërisë kryhet në përputhje dhe sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Ortaku I vetëm do të emërojë një apo më shumë ekspertë kontabël të autorizuar në ato raste kur emërtimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.



NENI 14

VITI FINANCIAR

14.1 Viti financiar i shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron me 31 dhjetor të çdo viti.

NENI 15

BILANCI VJETOR

15.1 Administratori merr masa lidhur me nxjerrjen e bilancit vjetor të hartuar konform ligjit mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

15.2 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventari, raportet e ekspertit kontabël të autorizuar miratohen nga administratori.

KREU VI

PRISHJA DHE LIKUJDIMI, LIGJI I ZBATUESHËM, ZGIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

NENI 16

PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË

16.1 Në rastin e prishjes dhe likujdimit të shoqërisë do të zbatohen dispozitat e parashikuara në ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.

NENI 17

LIGJI I ZBATUESHËM

17.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Akt Themelimi e Statut dhe ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë akt, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare.

NENI 18

ZGIDHJA E MOSMARRËVESHJES

18.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve apo ndërmjet ortakëve dhe trashëgimtarëve të ortakëve ose ortakëve të tjerë dhe/ose Shoqërisë, që kanë për

objekt të drejta të lidhura me Shoqërinë, do të zgjidhen miqësisht ndermjet palëve të interesuara. Në rast se palët nuk arrijnë në zgjidhje miqësore, Gjykata e Rrethit Gjyqdsor Tiranë do të jetë kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

NENI 19


TE NDRYSHME

19.1 Per ceshtje që nuk parashikohen dhe rregullohen shprehimisht nga ky statut, gjejnë referim dispozitat e Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtarët dhe shoqërite tregtare".

19.2 Statuti hartohet dhe nënshkruhet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

THEMELUES/ADMINISTRATOR

SKËNDER GJONI



A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Skender Gjoni", is written over a horizontal line. The signature is stylized and cursive.



AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR **“PLATINUM CONSTRUCTION” SHPK**

Sot me datë 01.06.2021, mbështetur në Kushtetuten dhe Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë, në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe në ligjin Nr.9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", me vullnetin e tij të lirë të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt themelimi nga ortaku i vetëm :

- Z. Skënder Gjoni, shtetas shqiptar, lindur në Tpla dhe banues në Tiranë, i datëlindjes 05.02.1958, identifikuar me pasaportën me nr. BF4358275 dhe nr. Personal: F80205129V, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

KRIJIMI

NENI 1

Sot me datë 01.06.2021, formohet shoqëria e quajtur "PLATINUM CONSTRUCTION" SHPK. Shoqëria do të nënshtrohet legjislacionit shqiptar. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortaku i vetëm themelues.

SELIA E SHOQËRISË

NENI 2

Selia e shoqërisë "PLATINUM CONSTRUCTION" SHPK ndodhet në adresën : Rruga Bulevardi Zogu I Pare, Nr. 5, Hyrja 5, Apartamenti 7, Kodi Postar 1016, Tiranë, Shqipëri. Me vendim të administratës selia e shoqërisë mund të ndryshohet, mund të hapen degë dhe zyra përfaqësimi të saj brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

NENI 3


KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do jetë me një afat kohor të pakufizuar.

NENI 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke u fokusuar kryesisht në:



Projektim dhe ndertimi i objekteve civile apo industriale dhe menaxhimi i zbatimit te projekteve te kesaj natyre per vete dhe per te trete; Shitja e objekteve / njesive te ndertuara si investitor dhe/ose dhenia e tyre me qira; Shfrytezimin e zonave malore apo bregdetare/plazheve per qellime turistike, duke administruar, dhene me qira, ndertuar objekte rekreative dhe duke ofruar sherbime ne fushen e turizmit, argetimit, bar, restorante ne zona turistike etj.; Importi-eksporti shitja me shumice e pakice e lendeve te para te ndertimit, pajisjeve elektrike, elektronike, hidrosanitareve, mobileri, pajisje zyrash, kancelari,automjete,mjete motorrike, pjese kembimi auto e makineri te çdo lloji, pajisje teknologjike etj. Transporti i mallrave dhe udhetareve brenda dhe jashte vendit; Ofrimi i sherbimit te konsulences ne fushen e biznesit, menaxhimit, taksave etj. Kryerjen e aktivitetit te menaxhimit te riskut dhe sherbimeve keshillmore te sigurise dhe shendetit ne pune. Sherbime parkingu, sherbime lavazhi,sherbime turistike.Dhenien e automjeteve me qera. shitje automjetesh te perdorura.Shitje makinash.Vleresim te pasurive te paluajtshme. Gjithashtu, Shoqeria mund te kryeje cdo lloj veprimtarie apo trasaksion tjetër që lidhet me pasuri të luajtshme e të paluajtshme, me kryerjen e veprimeve tregtare, industriale, bankare dhe/ose financiare të çfarëdo lloji dhe natyre, të nevojshme ose të dobishme për arritjen dhe ose plotësimin e objektivit të Shoqërisë, që nuk ndryshon aktivitetin përsos të Shoqërisë dhe nuk bie në kundërshtim me legjislacionin shqiptar në fuqi. Import eksport dhe tregtim me shumicë e pakicë të mallrave të ndryshëm ushqimorë, bimë medicinale, industriale, elektroshtëpiake, karburantë.Fabrike uji dhe perpunim lengjesh.Kryerja e investimeve të ndryshëm në sektorët e ndërtimit, rrugë, ura, nënkalime, mbikalime, vepra arti të mëdha dhe të vogla, autostrada, trase, porte, aeroporte, hekurudha, diga, tunele etj. Linja ujësjellësi, gazesjellësi, depo uji, vepra vaditëse etj. Vepra mbrojtëse lumore, hidroteknike, bonifikime etj, punime në gurore, material inerte etj, Punime impjanti të energjisë elektrike, centrale, hidrocentrale, stacione e nënstacione elektrike, kabina e transformatorë, linja elektrike të tensioneve të ndryshme si dhe të shpërndarjes. Punime ndërtime detare dhe nën ujë. Punime të ndryshme të inxhinierisë të mjedisit. Punime për ndërtime civile, industriale, turistikë, përfshirë punime për plotësim me rifiniturat, suva, gipse, drurë, duralumin, plastikë, xhami, etj. Rikonstruksione objektësh ndërtimore etj, impjante të brendshme elektrike, hidraulike, telefonie telekomunikacione, interneti, tv. kondicionim, aspirim, etj. Ndërtime parafabrikat, konstruksione metalike, druri, etj. Punime impjante hidrosanitare, ngritëse e transportuese etj. Punime të mbrojtjes dhe sinjalistikës rrugore, Punime strukturore shtresa e mbistruktura speciale, punime gjeodezike, punime gjeologo -inxhinierike etj, por pa u kufizuar në këto projekte dhe investime të ndryshme në to. Transporti rrugor, hekurudhor, ujor dhe ajror. Projektim, ndërtim dhe mirëmbajtje në fushën e Hoteleri Turizmit, të infrastrukturës, qendrave të biznesit etj. Ndërtim dhe shfrytëzim i pikave të shpërndarjes së karburanteve dhe serviseve e parkingjeve për automjete.

NENI 5

KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali i shoqërisë "PLATINUM CONSTRUCTION" është 100.000 (njëqind mijë) lekë.Kapitali i shoqërisë nënshkruhet menjëherë dhe do të paguhet nga ortaku i vetëm që zotëron 100% (njëqind përqind) të kontributeve në kapitalin e shoqërisë, përkatësisht :

- Z. Skënder Gjoni, shtetas shqiptar, i lindur në Tpla, më 05.02.1958, identifikuar me pasaportën me nr. BF4358275 dhe nr. Personal: F80205129V.

Ky kapital është i ndarë në 1 (një) kuotë të zotëruar 100% (njëqind përqind) nga ortaku i vetëm si më sipër.

NENI 6

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj dhe përfaqësuesi ligjor i saj. Ai është përfaqësues i shoqërisë në mardhënie me të tretët dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj.

Çdo kontratë do të kryhet prej tij dhe në rast mungese nga një përfaqësues i pajisur me prokurë të posaçme.

NENI 7

TE ARDHURAT

Te ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakëve të shoqërisë.

NENI 8

KONFLIKTET

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit shqiptar, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 9

VULA

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme, me logon dhe tekstin brenda saj.

NENI 10

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe veçanërisht të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombëtare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri. Çështjet që nuk trajtohen në këtë Akt Themelimi, rregullohen në Statutin e Shoqërisë si dhe në legjislacionin përkatës shqiptar.

Akti i themelimit, u përpilua në 5 kopje, për t'iu shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë "PLATINUM CONSTRUCTION" SHPK. Akti i themelimit u nënshkrua rregullisht nga themeluesi i shoqërisë.

THEMELUES/ADMINISTRATOR

SKËNDER GJONI

